

ERIONA TARTARI KËRTUSHA

**MENDIME, TEZA, HIPOTEZA MBI VEPRËN E BOGDANIT
ME RASTIN E RIBOTIMIT TË LETËRKËMBIMIT TË TIJ
ME PROPAGANDA FIDE-N**

Shoqëria jonë me kohë të përshpejtë dhe me kujtesë të dobët, prej disa vitesh ka shpikur shijen e përkujtimeve. Ditëlindje të çdo lloji; nga muzika tek letërsia, nga fitoret luftarake tek qytetërimet e harruara, nga figurat politike tek zërat e shkencës, të gjitha, ndjekin njëra tjetrën dhe herë pas here asnjësohen. Kujtesa jonë, shpesh e zbrazur, vuan nga ngarkesa e tepërt dhe nuk dallojmë dot më kush dhe çfarë meriton nderimet e vërteta.

Figura e Bogdanit është tipike e kësaj situate. Megjithëse studiuesit dhe shkrimtarët shqiptarë nuk e kanë injoruar kurrë Bogdanin, për shumë vite për të është folur kalimthi dhe ndonjëherë me gjysmë zëri, ndërkohë që, katër shekuj pas vdekjes së tij, struktura e mendimit që ndërtoi, gjuha që ai përpunoi, hapja me të cilën ushqeui qytetërimin shqiptar, vijnë ndërherë si dëshmitarët më të çmuar dhe ndoshta të vetëm të një kulture, letërsie dhe qytetërimi të përbashkët me Evropën ku përkohjmë sot. Dhe si një paradoks, ndërtohet kontrasti midis pamohueshmërisë së veprës së tij prej të mëdhenjve të Gjuhës dhe të Letërsisë shqipe, gati si drita që nuk e fshehim dot, dhe mosnjohjes që gëzon ajo dhe autori i saj, gati si verbim që na pengon të shohim nga vijmë e ku po shkojmë. Ndoshta, është ende i pashteruar ai që shërbeu, zhvilloi e përhap *Fjalën*, duke sjellë *Frymën* dhe *Idetë*. Dhe megjithëse, sot, pavarësisht se ç'thuhet, ai duket se e ka humbur në të vërtetë luftën për një shëmbëllim më të arsyeshëm të botës shoqërore dhe shpirtërore shqiptare, e më tej të asaj ballkanase, fati tragjik që pësoi, si litar i trashëguar prej shekujve, na bashkon vllazërisht me të, ashtu siç përbashkoi ai gjuhën shqipe me *Burimin e gjallë e të pashtershëm*. Duke e njohur këtë lidhje, ne njihemi më mirë me vehten, duke mos e mohuar atë bëhemi shqiptarë, duke e trashëguar

mbetemi të tillë; rreziku i verbimit, në këtë rast, ai i mosnjohjes së trashëgimisë sonë, nuk qëndron tek të ligët, siç jemi mësuar ta qëndrojmë gjithmonë, edhe kur tregtojnë rëndomtë, ndonjëherë nën petkun e eruditëve, vlerat dhe versionet zanafillore të kombit shqiptar, por tek heshtja e dashamirësve. Vepra e Bogdanit është një monument i letërsisë shqipe, i neglizhuar për arsye që do të përpiqemi ti shtjellojmë më poshtë, por edhe për pretekste të natyrës së saj religjioze¹. Të mos harrojmë në parantezë se, për të njëjtat pretekste, edhe metafizika e Dekartit, nuk ka ardhur ende në gjuhën shqipe. Harresë e një filozofie kritike që qëndron në themelet e mendimit iluminist evropian?! Vepra e Bogdanit, intelektual poliglot dhe anëtar i denjë i Kishës shqiptare, – bashkëkohës “i panjohur” i Dekartit, në marrëdhënie dhe mirënjohje me Venecian dhe Romën e shekullit të XVII, pra me vatrat më të mëdha të kulturës europiane të kohës – përfshin literaturën shqipe në rrjetet letrare dhe filozofike më në zë.

Sot, të paktën Bogdani duhet rilexuar; por cili Bogdan? Sepse ka shumë personazhe; secili i rëndë, sovran, por i ndërthurur brenda të njëjtit person. Është Bogdani i gjuhës dhe letërsisë shqipe; ai, që zbulojmë me vrap e tërthorazi në shkollë si një fillim të largët e të fjetur të poetikës shqipe; le të kujtojmë Shuteriqin që shtjellon mbi Bogdanin: «Bogdani, ndonëse më pak se Budi, lëroi edhe vjershërinë. Ai tregohet m’i shkathët i vargu e i strofës, po nuk mund të thomi se kemi të bëjmë edhe këtë radhë me një poet të frymëzuar. Edhe vjershat e tij janë fetare...»².

Është ai që megjithëse prift, me krenari e shpallim si Shqiptarin e madh në mbrojtje të idealit humanist Evropian; Bogdani poliglot e

¹ Preferojmë të shpjegojmë këtu arsyen e përdorimit të fjalës *religion*, e cila haset edhe tek autorë të shekullit të shkuar, si p.sh. Atë Anton Harapi, Eqrem Çabej, etj., dhe ka prejardhje nga latinishtja *religio*, fjalë e cila buron nga *religo*, në shqip *lidh*; do të thotë pra lidhja me forcën e mbinatyrshme, Zotin. Përdorimi i kësaj fjale në gjuhën shqipe është gati i detyrueshëm në disa raste, për të dhënë një kuptim që fjala *religion* e mbart historikisht dhe fjala *fe* nuk e përcjell. Shih mbi këtë edhe *Fjalori Teologjik*, të përshtatur në shqip nga Odette Marquet.

² Dh. S. Shuteriqi, *Histori e Letërsisë Shqipe*, për shkollat e mesme, botimi i dytë, Tiranë, 1958.

përkthyes, Bogdani teolog e filozof; edhe Rugova do të shprehej për Bogdanin: «...në aktivitetin dhe në veprimin jetësor Bogdani ishte intelektual; ai përpiquej për pasurimin e kulturës dhe për vendosje të kontaktit me dijen evropiane të kohës, përmes planit të kulturës dhe të dijes. Ai, brenda konceptcionit dhe orientimit të tij filozofik, kërkonte dhe konstatonte në frumë të kohës së vet, se Feja pa dije nuk mund të qëndrojë...»³

Cili prej këtyre personazheve, që shfaqen si shumësi hireshe dhe dhuratash brenda shpirtit të Bogdanit do të mund të rilexonim sot? Në një kohë përkimesh e përkujtimesh, imponohet natyrshëm leximi i letrave të shkruara gjatë periudhës së shërbimit të tij si Ipeshkëv i Shkodrës dhe i Tivarit, që prej emërimit nga Propaganda Fide në tetor të vitit 1965. Falë punës së përkushtuar dhe të heshtur të motrës së vogël Odette Louise de Jésus, aty do të zbulojmë Bogdanin që dëshmon «epilogun e historisë së gjatë me Perandorinë osmane» nëpërmjet një pjese të jetës së tij personale, një jetë e shprehur me shërbim për të afërmit, me besim, me përkushtim e bindje deri në martirizim. Martirët tregojnë, dëshmojnë dhe Bogdani sot e ka përmbushur dëshirën e tij. Ai dëshmon besimin dhe trashëgon përjetësinë. Në këto letra, ku Bogdani ndjente pasqyrën zmadhuese të qytetërimit të ardhshëm shqiptar, do të njohim lutjen, përshpirtësinë, shqetësimin e tij për mënyrën se si ky qytetërim po ndërtohej, me gurët e themelit në intrigat e botës orientale, të cilën pa faj e quan disa herë *barbareske*... Ai nuk urren asgjë më shumë se fanatizmin, intrigën dhe barbarinë dhe këndon si një paraardhës i Iluminizmit:

... *kaq madhështore është,*
Begatia e gjuhës së ditur
*Mendja e etur për dije...*⁴

Letërkëmbimet zbulojnë edukatorin intelektual, por në të njëjtin plan edhe bariun besnik. Në krah të Kishës dhe fesë së tij ngrihet

³ I. Rugova, *Vepra e Bogdanit*, 8 Nëntori, Tiranë, 1990.

⁴ P. Bogdani, *Cuneus Prophetarum* (Çeta e Profetëve), botim kritik, përgatitur nga Anila Omari, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2005.

shkenca dhe dëshira për arsyen. Dokumentet na tregojnë sesi me Bogdanin, në këtë pjesë të errët dhe persekutuese të historisë së shqiptarëve lind edhe një frymë e re, ku krahas rezistencës ndaj turkut, shprehet kërkshëria për kërkime, libra e meditime. Ku besëtytnitë dhe fanatizmat ia lënë vendin dijes dhe besimit të lirë. Por përveç dashamirësve të librit, historianëve dhe letrarëve, leximi i letërkëmbimeve të Bogdanit, sikurse edhe përvjetori e përkujtimi i kthimit të tij në shërbim të Kishës shqiptare, na fton të gjithëve të meditojmë, dhe të kthehemi në njerëz shpirtëror, sepse siç do të profetizonte edhe një francez i madh, André Malraux, sikur ta kishte profetizuar për shqiptarët sot, bota e këtij shekulli do të jetë shpirtërore ose nuk do të jetë fare.

Argumenti teorik:

Shekulli i kaluar dallohet për teoritë dhe përkufizimet e vijueshme mbi faktin letrar, përkufizimet mbi funksionin e letërsisë, të përdorimit të gjuhës letrare dhe të pushtetit që ajo ushtron mbi shoqërinë. Të mos harrojmë se në shekullin e kaluar u vendos për letërsinë shqipe një gjuhë e unisuar në fshirje të dialekteve. Në studimet letrare shqiptare u vendosën teori radikale mbi konceptin e letërsisë si ligjërim specifik, një ligjërim në funksion të botës realiste por me të dhëna estetike jashtë botës reale, teori këto që polarizuan ligjërimet dhe tekstet letrare, ndaj ligjërimeve të tjera. Për të marrë vetëm një shembull mbi këtë do të kujtonim tekstin e Jean Jacques Rousseau-it *Emili ose mbi edukimin*, në shqip, një vepër letrare përveçse filozofike dhe politike që i drejtohet një lexuesi specifik, pedagogëve dhe mësuesve⁵. Ky rast na tregon qartë, sesi një vepër romaneske, mirëfilli letrar, humbet gjatë përkthimit në shqip pritjen

⁵ Eriona Tartari Kërtusha, *L'esprit des Lumières en Europe de l'Est. Traduire Jean Jacques Rousseau en Albanie*, édition de l'Harmattan, Paris, 2016. Shih edhe: Zhan Zhak Ruso, *Emili ose mbi edukimin*, përktheu Sotir Paparisto, Tiranë, 1968. Në mbyllje të librit autori shënon: "Shokë Arsimitarë! Në këtë përmbledhje janë përfshirë pjesë nga "Emili", që kanë më shumë interes për arsimtarët tanë dhe që japin një sintezë të mendimeve pedagogjike të Russoit. Nga ky botim janë mënjeluar pjesët, që koha i ka zhvlerësuar. Duke plotësuar bibliotekën tuaj pedagogjike, duke ju njohur me idetë e përfaqësuesve më të shquar të mendimit pedagogjik, ne dëshirojmë të dimë vërejtjet dhe dëshirat tuaja rreth botimeve të drejtorisë sonë (...)"

e saj estetike duke humbur kështu edhe lexuesin, edhe komunikimin me ligjërimet filozofike, pedagogjike dhe politike të kohës⁶.

Në historiografinë dhe studimet letrare albanologjike, trashëgimia e formalizmit rus – ai vetë në vijimësi të romantizmit gjerman – dhe përshtatja me ideologjinë e realizmit socialist, zhvilluan një koncept të letërsisë si qasje formale duke i specifikuar ligjërimet letrare si të veçanta dhe të palidhura me ligjërimet e tjera sociale, politike, komunikative.

Ky koncept i letërsisë u shfaq dhe u përhap edhe në teoritë kritike të artit, në një perspektivë ontologjike të autonomisë së faktit estetik⁷. Të gjitha këto këndvështrime teorike shpërfillën faktin se gjuha dhe letërsia shqipe e çdo kohe, edhe ajo e gjysmëshekullit të kaluar, si çdo gjuhë dhe çdo letërsi tjetër, nuk është zhvilluar dhe nuk është shkruar brenda një qarku kombëtar dhe të izoluar, por, në të kundërt nga ajo që kemi menduar gjatë shekullit të shkuar, ajo ka jetuar dhe mbijetuar gjithnjë prej këmbimeve dhe komunikimeve me gjuhët, kulturat dhe letërsitë e tjera dhe për të kuptuar këtë, për të njohur rrjetin e gjerë të lidhjeve të shumta kulturore në letërsinë shqipe, duhet thyer ky qark fars i «dyerve të mbyllura».

Edhe sot, historiografia letrare vijon të konceptohet në terma periodikë, përkufizues, vijon të ndahet në autorë të mëdhenj, të mesëm dhe të vegjël, të sistemohet në antologjitë e veprave të

⁶ Mbi studimi i këtij teksti të shqipëruar prej Paparistos në vitet 66, shih edhe: Eriona Tartari, “Qasje epistemologjike mbi përkthimin në letërsinë shqipe”, në *Studime letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2016.

⁷ Mbi përhapjen e romantizmit gjerman në letërsinë e Europës së Lindjes dhe të Juglindjes shih: Eqrem Çabej, *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, Çabej, Tiranë, 1995. Përveç kësaj, Çabej na kujton se zhvillimi i romantizmit në literaturat e ndryshme të Europës perëndimore e veriore dhe në Rusi ka natyrë të ndryshme me ato të viseve të tjera të Europës lindore dhe juglindore. «...te kombet e Lindjes na shfaqet më fort funksioni nacional dhe etik i literaturës, te kombet e Perëndimit më fort ana artistike e saj», f. 62. Për sa po shohim, mund të mendojmë, duke mbështetur kështu argumentet tona teorike, se edhe trashëgimia e formalizmit rus, edhe ideologjia e realizmit socialist, përqafoi dhe përshtati në vijim të Rilindjes Kombëtare, një natyrë të ndryshme dhe të sajën në literaturën shqipe.

mëdha, antologji e mbrujtur në rrëfimin e izoluar dhe izolues kombëtar, vijon të transmetohet prej autorëve kanonikë shpesh të vendosur si të tillë prej një ideologjie të caktuar dhe ndoshta edhe të harruar. Edhe këtu, brenda këtij përfytyrimi teorik, rasti i Bogdanit është tipik; sot tekstet e tij do të duhej të trajtoheshin dhe të studioheshin në një perspektivë transnacionale, sepse në të vërtetë ai i përket mirëfilli humanizmit europian, duke e ngritur kështu letërsinë shqipe si të barabartë me letërsitë evropiane humaniste, gjë që nuk e bëri dot letërsia romantike e Rilindjes Kombëtare⁸. Jo vetëm letërkëmbimi i tij me Propaganda Fide-n, por, dhe mbi të gjitha, vepra e tij *Cuneus Prophetarum*, e para e këtij lloji në letërsinë shqipe, pret një trajtim ndërfaqësor, ku edhe studimet historike, edhe ato gjuhësore, letrare, filozofike e teologjike mund të gjejnë parimet dhe gjurmët e tyre⁹. Në rrethet shkencore të shqiptarëve të Arbërisë, por edhe tek shqiptarët e Kosovës është hedhur dritë mbi përkatësinë e veprës së Bogdanit në letërsinë humaniste dhe iluministe evropiane. Rugova, siç e thamë më lart, ka drejtuar lexuesin dhe albanologët kah një leximi filozofik dhe teologjik të tekstit të tij. Odette Marquet, në transkriptimin përkthimin dhe leximin e letërkëmbimeve, ka hedhur dritë mbi aktivitetin e këtij rilindasi humanist dhe rolin e tij në një rilindje të letrave shqipe, krahas rilindjes së vërtetë evropiane dhe përpara shfaqjes së rilindjes romantike kombëtare nga zgjedha osmane, për përparimin e gjuhës dhe dritës së diturisë në letrat shqipe.

Ndoshta do të duhet që, jo vetëm vepra e Bogdanit, por të gjitha veprat dhe aktivitetet letrare, të pashkëputura nga ato filozofike, teologjike dhe politike të «periudhës së errët» të letërsisë shqipe, – kohë e shekujve XVII-XVIII, e cila kalon pothuajse në heshtje në historiografinë shqiptare – të rilexohen sipas një metode të re, në natyrën e trajtimit ndërdisiplinor dhe ndërkulturor, por edhe në natyrën e periodizimit të tyre në raport me letërsitë e tjera. Shpesh, qarkullimi i kulturave dhe njohja e tyre është konceptuar prej idesë

⁸ Shih përsëri mbi këtë ide tekstin e cituar më lart të Eqrem Çabej-it.

⁹ Një vepër hyrëse në këtë këndvështrim është vepra e Ibrahim Rugovës e cituar më lart.

së krahasimit të letërsive të mëdha dhe të vogla, të kulturave qendrore dhe periferike, të modeleve që kanë në qendër rrymat europiane, ndërkohë që, tekste si ky i Bogdanit, japin dhe marrin prova të një ekuilibri dhe origjinaliteti estetik të barabartë, të një transversaliteti dhe shkëmbimi letrar horizontal, prova këto që na ftojnë të mendojmë ndryshe. Pa menduar me terma të «ndikimeve» të ushtruara nga letrat e njohura si qendrore, në letrat shqiptare, të konsideruara si periferike, as edhe me termat e «identitetit kombëtar», propozojmë rileximin e tekstit të Bogdanit i cili ngjan sot me një literaturë të hapur dhe me një ndërtim pjellor dhe të pasur në këndvështrimin e komunikimit ndërkulturor.

Interesi historik dhe epistemologjik

Është e vërtetë se lëvizja humaniste dhe rilindja evropiane u nxitën prej reformës dhe kundërreformës religjioze dhe nëse në Europën veriore dhe të mesme reforma ishte drejtuar kundër fesë katolike, në Europën qendrore dhe juglindore, më vonë siç po e shohim edhe në Gadishullin e Ballkanit, kundërreforma u përqendrua me të gjitha format kundër doktrinës së Luterit. Në këtë rrymë, Këshilli i Trentos, i cili mbaroi në vitin 1560, shqyrtoi pikat dhe akset kryesore të kundërreformës. Por, duke pasur parasysh komunikimin e ngadalshëm të asaj kohe, këshillat dhe udhëzimet e tij filluan të praktikohen më shumë në shekullin e XVII. Një nga drejtimet e këtij këshilli është reforma e klerit katolik dhe shpërndarja e Historisë së Shenjtë, e elementeve katekiste në një numër të madh të besimtarëve. Përhapja e kësaj literature u bë në të gjithë Europën nëpërmjet veprave të ndryshme që nuk ishin vepra të mirëfillta teologjike, por me divulgime të mendimit biblik dhe atij të krishterë në njërin apo tjetrin aspekt të dogmës, dhe me hapjen e shkollave. Është kjo lëvizje e Këshillit të Trentos që krijoi edhe kongregatën e Propaganda Fide-s, dhe emri e thotë mirë atë që thotë. Në këtë kontekst, dhe në dëshirën për të krishterizuar dhe për të luftuar kundër injorancës, Bogdani përkthen, predikon, mëson dhe

shkruan veprën e tij më të rëndësishme mbi jetën e Krishtit¹⁰. Me qëllim përhapjen e kulturës së besimit të krishterë në gjuhën shqipe, kjo vepër është përkthyer prej tij në italisht dhe përbën një interes të dyfishtë për studimet filologjike¹¹. Studimi i kësaj vepre do të na ndihmonte gjithashtu të kuptonim ripërtëritjen e kulturës së krishterë në atë kohë në trevat shqiptare, krijimin e një pedagogjie të re për njohjen e Biblës dhe të jetës së Krishtit. Për këtë pjesë të historisë së zhvillimit të literaturës Çabej shkruan: «Kundërreforma me atë frymë universale dhe me atë organizim në metodë, të cilat që në kohë të lashta kanë cilësuar kishën romake, iu përvesh luftës kundër doktrinės së Luterit. Kjo luftë u luftua me shpatë dhe me pendë; kështu që, siç do të shohim më imtas poshtë, pati pasojë për literaturën e shumë viseve katolike të Europës, sidomos të viseve më të vogla. Ne ndodhemi në këtë lëmë përpara faktit të shënueshëm që kisha universale e Romës me latinishten si gjuhë liturgjike nuk pa ndonjë rrezik për vete të saj që fjala e Zotit të thuhej në këto vende në gjuhën kombëtare të secilit vend. Përkundrazi, duke luftuar me të njëjtat armë sipo luftonte reforma, kisha romake e përkrahu këtë zhvillim: sepse në lulëzimin e gjuhëve nacionale ajo pa mjetin për ti mbajtur kombet në gjë të fesë katolike, për t'i forcuar në të si edhe për t'i kthyer rishtas në këtë besim.¹²»

Vetë Bogdani shkruan: «E madhe dobë e frujt është prë me ndërequnë këtë shkallë t'urtisë, e me të shkruem bukurë me shqyrëtuem e me dijtunë se si duhetë nierit temelitunë me u përcjellë sã është mbë këtë jetë, me frujt të shpirtit vet ende të popullit, të mos lanë dijenë e giuhën' e dheut me u dvarunë, posi lëfton gjithë

¹⁰ *CUNEUS PROFETARUM DE SALVATORE MUNDI ET EIUS EVANGELICA VERITATE, ITALICE ET EPIROTICE, CONTEXTA* ...doli në shqip më 1685 dhe u ribotua më 1691: *L'Infallibile verità della cattolica fede dimostra nella vita di GESU CHRISTO*.

¹¹ Mbi historinë e përkthimit dhe të botimit të veprës, shih siç thamë më lart: *Pjetër Bogdani, Letërkëmbim, Ipeshkëv i Shkodrës dhe Administrator i Arkipeshkvisë së Tivarit, (1660-1670)*, pregatiti për botim Odette Marquet, Një pjesë e mendimit tonë për veprën e Bogdanit gjendet në këtë botim, IDK, Tiranë, 2016.

¹² E. Çabej, vepër e cituar më lart, f. 66.

dheu e shekulli për të vet; po tue u nalcuem prej urtishit andej ta ketë udob të fluturuemitë mbi qiellt e ndë Parrīsit.¹³»

Dikur, prirjen e tij iluministe, Bogdani, siç parashtonte edhe Dekarti prirjen e tij mbi arsyen, nuk e shkëput aspak prej vijimësisë së një logjike dhe besimi të krishterë: «E shofëmë përditë se nd atë dhë ku lulëzojnë dotorëtë, letërarëtë e dijeja lulëzon ende shëjteja fë, me gjithë vepëra të mira, e nd atë dhë ku nukë janë dotorëtë, letërarëtë e të dijtëshimitë fëja sã e ka përditë lëngon, ligetë e shqimbetë: vepëratë e mira, uratëtë, lëmoshënatë e njinesëtë venë tue u dvarunë.¹⁴» Sot, Joseph Ratzinger mbron tezën e perceptimit të iluminizmit europian jo si shkëputje por si vijimësi e kulturës së krishterë¹⁵.

Kështu Shqipëria, në një farë mënyre vijë kufitare e krishtërit, meqë vendi ishte nën pushtimin turk, kërcërimi i të cilëve në këtë shekull të XVII ishte i egër, ka marrë pjesë në Këshillin e Trentos dhe vetë vepra e Bogdanit e sugjerimet e saj do të ndikojnë më vonë mbledhjen dhe vendimet e Këshillit të Arbërit. Është koha kur Perandoria Osmane, njeh fitoret e saj më të mëdha dhe shtrin influencën deri në muret e Vjenës, rreth vitit 1680. Në këtë drejtim puna e Bogdanit ka qenë një punë pionieri. Siç e dëshmojnë letrat e Bogdanit, kjo pjesëmarrje ka qenë e vështirë dhe e dhimbshme, po aq e vështirë, e dhimbshme dhe e gjatë sa edhe zhbimi i Perandorisë Osmane në këtë pjesë të Europës.

Në një tjetër raport midis tematikës dhe kronologjisë, vepra e Bogdanit *Cuneus Prophetarum*, ka një tjetër interes epistemologjik. Nën dritën e letërkëmbimeve, rileximi i tekstit na drejton në leximin e koncepteve të ndryshme filozofike. Për të marrë vetëm një shembull mbi këto koncepte mund të përmendim idenë mbi «të keqen» dhe «fatkeqësinë»; nëpërmjet kuptimit filozofik dhe teologjik të «të keqes dhe «të fatkeqësisë» në veprën e Bogdanit, një çështje që zgjat dhe shtrihet në të gjithë historinë e tekstit biblik,

¹³ P. Bogdani, *Cuneus Prophetarum*, vepër e cituar më lart.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Shih për këtë J. Ratzinger, *Une nouvelle culture pour un nouvel humanisme*, Parole et silence, 2012.

zbulojmë interesin dhe rëndësinë e tekstit dhe të «kootekstit» në interpretimin dhe analizën letrare. Për më tepër objekti i leximit kritik të këtij teksti dhe secilit prej koncepteve që ai zhvillon, në një strukturë që nën shembullin e Biblës është ndarë në dy pjesë, do të sillte këndvështrimet dhe do të na njihte me shoqërinë dhe letërsinë tonë të asaj «kohe të errët».

BIBLIOGRAFI

- Bogdani, P., *Cuneus Prophetarum*, botim i përgatitur nga Anila Omari, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, IGJL, Tiranë, 2005.
- Bogdani, P., *Letërkëmbim, Ipeshkëv i Shkodrës dhe Administrator i Arkipeshkvisë së Tivarit, (1660-1670)*, përgatitur nga Odette Marquet, Botimet IDK, Tiranë, 2016.
- Bogdani: *Cuneus Prophetarum*. Part 1: *Vetus Testamentum*. Part II: *Novum Testamentum*. [Data entered by Michiel de Vaan, 2003, on the basis of the edition by Giuseppe Valentini and Martin Camaj, München 1977.
- Çabej, E., *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, Çabej, Tiranë 1994.
- Camaj, M., “Çelës për leximin e veprës”, në: *Cuneus prophetarum a Pietro Bogdano, Patavii MDCLXXXV*, R. Trofenik, München, 1977, f.16.
- Marquet, O., *Pjetër Bogdani. Letra dhe dokumente*, ShB. “At Gjergj Fishta”, Shkodër, 1997.
- Rugova, I., *Vepra e Bogdanit*, Prishtinë 1982.
- Shuteriqi, Dh.S., *Histori e Letërsisë Shqipe*.